

Standardi i Profesionit me bazë Rajonale

Formati i plotë i standardit me grupet e propozuara të detyrave/funksioneve

Standardi i Profesionit: Bravëndreqës

Profesioni: Bravëndreqës (Fonditori, saldatori, punëtor i llamarinës, përgatitës i konstruksioneve metalike)

Sektori: Inxhinieri mekanike (specifik për kodimin kombëtar)

Niveli ISCO: II

Përshkrimi i profesionit:

Bravëndreqësi (Fonditori, saldatori, punëtor i llamarinës, përgatitësi i konstruksioneve metalike) përgatit pjesë të konstruksioneve metalike, përpunon llamarina, profile metalike dhe tuba dhe kryen punime të ndryshme montimi. Bravëndreqësi (Fonditori, saldatori, punëtor i llamarinës, përgatitësi i konstruksioneve metalike) prodhon: gardhe me kangjella, porta, dritare dhe dyer, mobilje, pjesë të impianteve, objekte metalike dhe objekte me materiale të tjera.

Gjatë punës, bravëndreqësi (fonditori, saldatori, punëtor i llamarinës, përgatitësi i konstruksioneve metalike) kryen aktivitete të ndryshme në mënyrë të qëndrueshme në aspektin shoqëror dhe ekologjik: konturimin dhe shënjimin, prerjen manuale dhe mekanike, drejtimin, lakimin, mprehjen, farkëtimin, perçinimin, shpimin, filetimin, limimin, saldimit (me hark elektrik dhe gaz), montimin e komponimeve, mprehjen e mjeteve të ndryshme, mbrojtjen e sipërfaqeve me veshje mbrojtëse.

Bravëndreqësi (Fonditori, saldatori, punëtor i llamarinës, përgatitësi i konstruksioneve metalike) përdor një shumëllojshmëri mjeteve dhe makinerish: çekiç, sharrë hekuri, gërshërë llamarine, lima të ashpra, mjete matëse (metër, kalibër, mikrometër, raportor...), trapan elektrik dore dhe zmerilatriçe, makineri prerëse për profilin e çelikut, makineri për prerjen dhe përkuljen e llamarinës dhe profileve si dhe pajisje saldimit.

Bravëndreqësi (Fonditori, saldatori, punëtor i llamarinës, përgatitësi i konstruksioneve metalike) menaxhon dokumentacionin e punës dhe kryen detyra administrative dhe tregtare në fushën e punës së tij/saj. Ai/ajo komunikon me eprorët, kolegët, klientët, duke zbatuar rregullat e komunikimit të biznesit dhe koordinon kryerjen e punës me kontraktorët e tjerë në mënyrë etike dhe profesionale. Ai/ajo zbaton dhe garanton standarde cilësore në punën e tij/saj, zbaton procedurat dhe masat për ruajtjen e shëndetit, mbrojtjen e mjedisit të punës, si dhe masat për mbrojtjen nga zjarri.

Mjedisi i punës dhe kushtet e punës:

Bravëndreqësi (Fonditori, saldatori, punëtor i llamarinës, përgatitësi i konstruksioneve metalike) punon në reparte pune ose në terren, në ndërtesa banimi, tregtare ose industriale. Ai/ajo punon kryesisht në pozicion në këmbë dhe, nëse është e nevojshme, në lartësi dhe/ose në hapësirë të mbyllur, në ambiente të mbyllura, gjysmë të hapura dhe të hapura. Kjo punë zakonisht kërkon të qenit në gatishmëri për ofrimin e shërbimit në çdo kohë, dhe mund të jetë punë me turne, si dhe punë në terren me orar të zgjatur.

Bravëndreqësi (Fonditori, saldatori, punëtor i llamarinës, përgatitësi i konstruksioneve metalike) mund të punojë në mënyrë të pavarur, të koordinojë një grup të vogël punëtorësh dhe/ose të punojë nën mbikëqyrje. Puna ka rrezik të shtuar që mund të çojë në dëmtime mekanike, djegie, rrezik rënieje, goditje elektrike, ekspozimit ndaj rritjes së rrezatimit elektromagnetik, tymrave të dëmshëm, pluhurit, zhurmës së shtuar, dridhjeve, ndryshimeve të temperaturës dhe stresit psiko-fizik. Për shkak të specifikës së punës dhe rreziqeve ndaj të cilave është i ekspozuar bravëndreqësi (fonditori, saldatori, punëtor i llamarinës, përgatitësi i konstruksioneve metalike), vëmendje e veçantë i kushtohet përdorimit të pajisjeve mbrojtëse:



këpucë sigurie me mbulesë mbrojtëse, doreza mbrojtëse, syze mbrojtëse, mbrojtje për fytyrën dhe sytë (maskë mbrojtëse).

Punëdhënësi mund të parashikojë marrjen e masave për sigurimin e kushteve të veçanta në përputhje me vlerësimin e riskut të vendit të punës.

Marrëdhënia me profesionet e tjera:

Profesioni i bravëndreqësit (fonditori, saldatori, punëtori i llamarinës, përgatitësi i konstruksioneve metalike) vlen edhe për profile/kualifikime të tjera brenda të njëjtit sektor: ndihmës bravëndreqës (fonditor, saldator, punëtor i llamarinës, përgatitës i konstruksioneve metalike), bravëndreqës (fonditor, saldator, punëtor i llamarinës, përgatitës i konstruksioneve metalike) mekanik, saldator, montues, mekanik karrocierie, operator për impiante energjetike, mekanik për makineritë, metalprerës.

Përveç kësaj, bravëndreqësi (fonditori, saldatori, punëtori i llamarinës, përgatitësi i konstruksioneve metalike) mund të bashkëpunojë edhe me sektorë dhe profesione të tjera: teknikë shërbimi që merren me mirëmbajtjen e pajisjeve dhe makinerive, elektrikistë, furnizues të lëndëve të para dhe materialeve të tjera të prodhimit, punëtorë në sektorin e ndërtimit.



Standardi i Profesionit:

GRUPI DETYRAVE/ FUNKSIONEVE	DETYRAT KYÇE	AKTIVITETET
1. Analizimi, planifikimi dhe organizimi i punës	1.1. Analizimi, planifikimi dhe organizimi i aktiviteteve të punës	<p>1.1.1. Shqyrton rradhën e punës, dokumentacionin përkatës dhe informacione të tjera të nevojshme për realizimin e detyrës së punës.</p> <p>1.1.2. Rishikon dokumentacionin teknik (dokumentacioni teknik dhe teknologjik, manualët me udhëzime për funksionimin dhe mirëmbajtjen, etj.), në përputhje me kërkesat e detyrës së punës</p> <p>1.1.3. Planifikon kalendarin kohor për kryerjen e punimeve në faza (prerje, përkulje, mprehje, shpim, bashkim etj.), në përputhje me kërkesat e detyrës së punës, në mënyrë të pavarur ose në marrëveshje me eprorët.</p> <p>1.1.4. Planifikon burimet e nevojshme në përputhje me dokumentacionin teknik dhe teknologjik përkatës (burimet njerëzore, materialet, pajisjet, detyrat e punës), në përputhje me parimet e qëndrueshmërisë dhe efikasitetit të energjisë.</p> <p>1.1.5. Organizon grupet e punëtorëve të aftë për kryerjen e punimeve.</p> <p>1.1.6. Koordinon aktivitetet e tij/saj me aktivitetet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve të biznesit.</p> <p>1.1.7. Organizon punën në mënyrë të qëndrueshme, duke reduktuar humbjet në të gjitha hallkat e procesit, nga prodhimi në konsum.</p>
2. Përgatitja e vendit të punës	2.1. Përgatitja e burimeve dhe vendit të punës për kryerjen e punimeve	<p>2.1.1. Kontrollon kushtet e punës në vendin e punës në përputhje me masat e përgjithshme për shëndetin dhe sigurinë në punë (ndriçimi, ndotja, burimet e rrezikut fizik, kushtet meteorologjike...), duke marrë parasysh nevojat specifike/individuale të punonjësve.</p> <p>2.1.2. Përgatit vendin e punës në përputhje me kartën teknologjike/procedurën teknologjike, planin ditor të punës dhe prioritetet e punës, në përputhje me udhëzimet dhe rregulloret për shëndetin dhe sigurinë në punë.</p> <p>2.1.3. Përgatit dokumentacionin përkatës të nevojshëm për kryerjen e detyrës së punës.</p> <p>2.1.4. Përgatit materialet, mjetet, aksesoret dhe makineritë e nevojshme për zbatimin e detyrës së punës, në përputhje me dokumentacionin teknik dhe teknologjik dhe legjislacionin teknik.</p> <p>2.1.5. Përgatit veten për punë dhe përgatit mjetet mbrojtëse dhe pajisjet mbrojtëse.</p> <p>2.1.6. Ruan higjienën e vendit të punës, mjeteve dhe pajisjeve me përfundimin e detyrës së punës.</p>



3. Detyrat operative	3.1 Matja, skicimi dhe shënjimi në material	<p>3.1.1 Lexon dokumentet tekniko-teknologjike (skica, vizatime, projekte etj.) të nevojshme për detyrën e punës.</p> <p>3.1.2 Bën vizatimet e nevojshme për këtë detyrë pune.</p> <p>3.1.3 Merr dhe/ose kontrollon masat, në vend, duke përdorur mjetet dhe pajisjet matëse, në përputhje me dokumentet tekniko-teknologjike.</p> <p>3.1.4 Merr masat mbi material duke u bazuar tek vizatimi në dokumentet tekniko-teknologjike dhe sipas përpjestimit të përcaktuar, duke përdorur mjetet dhe pajisjet e duhura për skicimin dhe shënjimin.</p>
	3.2 Përgatitja e produkteve/elementeve dhe komponimeve të bravëndreqësit (fonditorit, saldatorit, punëtorit të llamarinës, përgatitësit të konstruksioneve e metalike)	<p>3.2.1 Pret tubat, profilet, llamarinat dhe pllakat në mënyrë racionale duke përdorur inputet dhe duke reduktuar humbjet në të gjithë procesin, duke përdorur makineritë dhe mjetet e duhura të punës.</p> <p>3.2.2 Formon tuba, profile, llarina dhe pllaka ose pjesë produktesh me makineri dhe mjete pune nëpërmjet deformimit plastik (në gjendje të nxehtë dhe të ftohtë).</p> <p>3.2.3 Hap vrima në përmasa të vogla dhe të mëdha duke përdorur makineritë dhe mjetet e duhura të punës.</p> <p>3.2.4 Përpunon produktet ose pjesët e produkteve duke zmeriluar ose gërryer me zmerilat/riçe dore në procesin e përgatitjes, fazës dhe/ose përpunimit përfundimtar.</p> <p>3.2.5 Pret/gdhend filetaturat e vidhave duke përdorur makineritë dhe mjetet e duhura të punës.</p> <p>3.2.6 Lidh pjesët e produkteve me nyjet e filetuara me vidha duke përdorur mjetet dhe makineritë e duhura të punës.</p> <p>3.2.7 Lidh elementet e produkteve me saldime, duke përdorur mjetet dhe makineritë e duhura të punës.</p> <p>3.2.8 Lidh pjesët e llamarinave dhe profileve me mënyra të tjera lidhjesh, (p.sh. kallaisje, ngjitje, gozhdim etj.) duke përdorur makineritë dhe mjetet e duhura të punës.</p> <p>3.2.9 Asgjeson produktet/elementet dhe pjesët e montuara në mënyrën e përcaktuar.</p>
	3.3 Montimi dhe çmontimi i produkteve/elementeve dhe komponimeve	<p>3.3.1 Inspekton kushtet aktuale të vendit të montimit.</p> <p>3.3.2 Kryen montimin/çmontimin e elementeve dhe komponimeve të prodhuara qoftë në kushtet e repartit të punës dhe/ose në vendin e montimit përfundimtar, në përputhje me dokumentacionin tekniko-teknologjik.</p> <p>3.3.3 Kontrollon korrektësinë e pozicionimit të elementeve dhe komponimeve të montuara në kushtet e repartit të punës dhe/ose në vendin e montimit përfundimtar, në përputhje me dokumentacionin tekniko-teknologjik.</p> <p>3.3.4 Kryen korrigjimet e korrektësisë së pozicionimit dhe dimensioneve të produkteve, elementeve dhe komponimeve të montuara në kushtet e repartit të punës dhe/ose në vendin e montimit përfundimtar në përputhje me kontrollin e kryer paraprakisht.</p>



	<p>3.4 Mbrojtja e sipërfaqes së produkteve/elementeve dhe komponimeve të përgatitura</p>	<p>3.4.1. Përgatit sipërfaqet e produkteve/elementeve dhe komponimeve të përgatitura (degreasimi, pastrimi, heqja e pluhurit dhe heqja e mbrojtjes së mëparshme) dhe veshjes mbrojtëse duke përdorur mjetet e duhura, në përputhje me dokumentacionin teknik dhe teknologjik dhe standardet ekologjike.</p> <p>3.4.2. Siguron mbrojtjen e sipërfaqes së produkteve/elementeve dhe komponimeve duke aplikuar veshje mbrojtëse (bazike dhe përfundimtare), duke përdorur produktet (bojra dhe llak), mjetet dhe pajisjet e duhura në përputhje me dokumentacionin teknik dhe teknologjik dhe standardet ekologjike.</p> <p>3.4.3. Kontrollon vizualisht sipërfaqet e produkteve/elementeve dhe komponimeve të mbrojtura.</p> <p>3.4.4. Korrigjon sipërfaqet e produkteve/elementeve dhe komponimeve të mbrojtura.</p>
	<p>3.5 Mirëmbajtja dhe riparimi i pajisjeve, materialit/elementeve dhe komponimeve</p>	<p>3.5.1. Bën pastrimin e përditshëm dhe kryen mirëmbajtjen e thjeshtë të pajisjeve dhe mjeteve të përdorura duke i riparuar ato.</p> <p>3.5.2. Mirëmban mjetet dhe pajisjet në gjendje funksionale gjatë punës.</p> <p>3.5.3. Kontrollon mjetet dhe makineritë, merr masa në rast dëmtimi të tyre dhe informon eprorët.</p> <p>3.5.4. Merr pjesë në aktivitetet që kanë të bëjnë me mirëmbajtjen parandaluese dhe të vazhdueshme të pajisjeve, sipas udhëzimeve të prodhuesve.</p> <p>3.5.5. Kryen rishikimin e vazhdueshëm dhe sipas nevojës të elementeve, komponimeve dhe produkteve në intervale të caktuara dhe në mënyrat e përcaktuara nga projekti për mirëmbajtjen.</p> <p>3.5.6. Rregullon defektet duke riparuar ose zëvendësuar elementë, komponime (elemente të gardheve me kangjella, elemente të dyerve, elementë dritarësh, korniza, traversa, etj.) dhe produktet e gatshme (gardhe me kangjella, dritare, komponime çeliku, konstruksione metalike, pjesë të ndryshme metalike, shkallë, strehë ndërtesash, etj.) duke përdorur mjetet, veglat, pajisjet dhe makineritë e duhura.</p>
<p>4. Detyrat administrative</p>	<p>4.1. Mbajtja e dokumentacionit të punës</p>	<p>4.1.1. Plotëson planin ditor dhe javor të punës sipas formateve të kërkuara.</p> <p>4.1.2. Mban evidenca në lidhje me gjendjen e makinerive dhe pajisjeve.</p> <p>4.1.3. Mban evidenca në lidhje me punët e kryera dhe rradhën e punës së përfunduar sipas formateve të kërkuara.</p> <p>4.1.4. Plotëson dokumentacionin përkatës për aktivitetet e kryera në përputhje me detyrën e punës (rradha e punës, raporti...).</p> <p>4.1.5. Merr pjesë në përgatitjen/përgatitje raporte periodike për punimet e kryera apo aktivitetet e kryera.</p> <p>4.1.6. Mban evidenca në lidhje me inventarët dhe konsumin e materialit, pjesëve të këmbimit, mjeteve të punës.</p> <p>4.1.7. Mban/arkivon dokumentacionin në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p>



5. Detyrat tregtare	5.1. Prokurimi i burimeve të nevojshme për punë dhe prodhim, përcaktimi i çmimit, promovimi i produkteve dhe shërbimeve	<p>5.1.1. Mbledh informacion mbi disponueshmërinë, çmimet dhe cilësinë e materialeve, mjeteve të punës, pajisjeve dhe burimeve për punë në treg.</p> <p>5.1.2. Kryen përzgjedhjen, blerjet dhe kontrollin e materialeve, mjeteve, pajisjeve të punës dhe burimeve të tjera të punës.</p> <p>5.1.3. Përgatit/merr pjesë në përgatitjen e ofertave për realizimin e punimeve (specifikimi i materialeve dhe punimeve, afatet dhe shpenzimet).</p> <p>5.1.4. Llogarit punimet dhe shërbimet e realizuara (përcakton çmimet), përgatit faturat dhe pro-faturat.</p> <p>5.1.5. Promovon/merr pjesë në promovimin/shitjen e produkteve dhe shërbimeve.</p>
6. Komunikimi dhe bashkëpunimi me të tjerët	6.1. Komunikimi me bashkëpunëtorët, klientët, institucionet kompetente dhe pjesëmarrësit e tjerë në procesin e punës	<p>6.1.1. Vendos dhe ruan komunikimin e brendshëm dhe të jashtëm në mënyrë profesionale dhe etike, duke ndjekur rregullat e komunikimit të biznesit, në përputhje me parimet e barazisë përsa i përket gjinisë, racës, seksit, kombësisë, fesë, kulturës etj., nëpërmjet përdorimit të teknologjisë bashkëkohore të informacionit dhe komunikimit.</p> <p>6.1.2. Komunikon me kolegët, klientët, institucionet përgjegjëse dhe pjesëmarrësit e tjerë duke zbatuar rregullat e komunikimit verbal dhe joverbal.</p> <p>6.1.3. Punon në grup duke zbatuar drejt parimet e punës në grup.</p> <p>6.1.4. Aplikon teknika motivuese për të vendosur komunikim të mirë me të tjerët.</p> <p>6.1.5. U jep udhëzime bashkëpunëtorëve dhe grupit të punës për zbatimin e një detyre pune duke përdorur terminologji të qartë dhe profesionale.</p> <p>6.1.6. Zgjidh ankesat dhe keqkuptimet e brendshme dhe të jashtme, duke përdorur teknikën e duhur për zgjidhjen e konflikteve.</p> <p>6.1.7. I raporton eprorit të tij/saj për detyrën e punës të realizuar duke përdorur terminologji të qartë dhe profesionale (në nivel eksperti).</p>
7. Sigurimi i cilësisë	7.1. Zbatimi i procedurave të sigurimit të cilësisë në përputhje me	<p>7.1.1. Zbaton rregulloret teknike, standardet e cilësisë dhe standardet e tjera, procedurat dhe udhëzimet e brendshme në zbatimin e detyrave të punës në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p> <p>7.1.2. Kontrollon/monitoron kushtet e punës që mund të ndikojnë në cilësinë e punës (temperatura, lagështia, ...).</p> <p>7.1.3. Përdor pajisjet, mjetet dhe aparaturat në përputhje me udhëzimet e prodhuesit.</p>



	<p>standardet përkatëse dhe rregulloret e tjera</p>	<p>7.1.4. Kryen kontrollin fillestar të materialeve dhe mjeteve (matjet bazë dimensionale dhe inspektimin vizual), në përputhje me rregulloret dhe specifikimet përkatëse.</p> <p>7.1.5. Kryen kontrollin e operacioneve të kryera sipas fazave të prodhimit, në përputhje me dokumentacionin teknik/planin e kontrollit.</p> <p>7.1.6. Kryen kontrollin përfundimtar të produkteve (kontrolli vizual, funksionaliteti, saktësia e matjes, ...).</p> <p>7.1.7. Kryen identifikimin dhe heqjen e defekteve të vërejtura (zgjidh ankesat) për të garantuar cilësinë e produkteve/punëve të kryera.</p> <p>7.1.8. Ndjek rregullisht kurse/trajnime për zbatimin e standardeve, teknikave dhe teknologjive të reja në profesionin e bravëndreqësit (fonditorit, saldatorit, punëtorit të llamarinës, përgatitësit të konstruksioneve metalike) si dhe trajnime për teknikat e komunikimit.</p> <p>7.1.9. Vlerëson punën e vet dhe punën e bashkëpunëtorëve, duke marrë parasysh natyrën specifike të punës dhe karakteristikat e punonjësve (faza e jetës, aftësitë fizike, etj.)</p>
<p>8. Mbrojtja në vendin e punës dhe mbrojtja e mjedisit</p>	<p>8.1. Zbatimi i procedurave dhe masave për sigurinë dhe shëndetin në punë</p>	<p>8.1.1. Zbaton rregulloret përkatëse statutores dhe të brendshme që rregullojnë shëndetin dhe sigurinë në punë, mbrojtjen nga zjarri dhe emergjencat.</p> <p>8.1.2. Përdor/kryen kontrollin e vazhdueshëm të pajisjeve mbrojtëse personale, makinerive, pajisjeve të punës, në përputhje me standardet dhe udhëzimet përkatëse.</p> <p>8.1.3. Përdor agjentë kimikë të rrezikshëm dhe potencialisht të rrezikshëm në përputhje me manualin e udhëzimeve, me qëllim ruajtjen e sigurisë dhe shëndetit në punë.</p> <p>8.1.4. Zbaton planin e evakuimit në rast emergjence duke ndjekur procedurat përkatëse.</p> <p>8.1.5. Identifikon dhe raporton në lidhje me mosfunksionimin e veglave, mjeteve dhe pajisjeve të punës te personi përgjegjës.</p> <p>8.1.6. Jep ndihmën e parë në rast aksidenti në përputhje me procedurat përkatëse.</p> <p>8.1.7. Zbaton protokollet e duhura në rast pandemie.</p>
	<p>8.2. Zbatimi i procedurave dhe masave për mbrojtjen e mjedisit</p>	<p>8.2.1. Zbaton masat, rregullat dhe standardet për mbrojtjen e mjedisit.</p> <p>8.2.2. E mban vendin e punës të pastër dhe të rregullt.</p> <p>8.2.3. Asgjeson, magazinon dhe seleksionon lëndët e para dhe të përpunuara, agjentët kimikë pa dëmtuar mjedisin.</p> <p>8.2.4. Kryen organizimin/përzgjedhjen, asgjësimin, ruajtjen dhe trajtimin e mbetjeve të krijuara në procesin e punës, në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e mjedisit.</p> <p>8.2.5. Zbaton masat për mbrojtjen nga ndikimi i çdo gazi të rrezikshëm, toksinave, avullimit, substancave tejet të ndezshme.</p> <p>8.2.6. Zbaton masat e nevojshme në rast të derdhjes së kimikateve ose rrjedhjes së ndonjë reagenti dhe lënde të ndezshme.</p>



		8.2.7. Përdor në mënyrë racionale energjinë dhe materialet dhe zbaton parimet e zhvillimit të qëndrueshëm mjedisor.
--	--	---

